

VENDIM
Nr. 552, datë 27.8.2014

**PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE, TË LËSHUAR NË FAVOR TË
BANKËS TREGTARE, RAIFFEISEN BANK ALBANIA, NË KUADËR TË KUSHTEVE
TË KONTRATËS SË KREDISË QË DO TË NËNSHKRUHET NDËRMJET KËSAJ
BANKE DHE KESH, SH.A.-SË**

(Ndryshuar me VKM nr. 685, datë 16.10.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 3, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të bankës tregtare, Raiffeisen Bank Albania, në kuadër të kushteve të kontratës të kredisë që do të nënshkruhet ndërmjet kësaj banke dhe KESH, sh.a.-së, për shumën ekuivalente në lekë të shumës 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) euro.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

(zëvendësuar me VKM nr. 685, datë 16.10.2014)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

Ministria e Financave

Nr. _____ prot.

Tiranë më _____ 2014

Garanci qeveritare

Në favor të: RAIFFEISEN BANK, SH.A.,

Me seli: “Rruga e Kavajës”, Tiranë, Shqipëri

Duke qenë se, sipas kontratës së kredisë nr. _____ Rep, nr. _____ Kol, datë _____, “Për lëshimin instrumenteve financiare dhe/ose kredi me kufi”, (këtu e më poshtë e quajtur “Kontrata e kredisë”), e lidhur ndërmjet Raiffeisen Bank, sh.a., (këtu e më poshtë “Banka”) dhe “KESH”, sh.a.-së, (këtu e më poshtë “Kredimarrësi”), Raiffeisen Bank, sh.a., ka rënë dakord të vendosë në dispozicion të “KESH”, sh.a.-së, shumën ekuivalente në lekë të shumës 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) euro për t’u përdorur nga kredidhënësi me qëllimin e çeljes së garancive bankare dhe/ose përdorimin e tyre si kredi me kufi në llogarinë rrjedhëse;

Duke qenë se sipas parashikimeve të kushteve paraprahe për disbursim fillestar dhe parashikimeve

të nenit 5 të kontratës së kredisë, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të kontratës nga ana e kredimarrësit, kërkohet lëshimi i një garancie nga qeveria e shtetit shqiptar, e vlefshme deri në shlyerjen e plotë të të gjitha detyrimeve sipas kësaj kontrate;

Duke qenë se Këshilli i Ministrave, me vendimin, nr. _____, datë _____ 2014, “Për miratimin e garancisë qeveritare të lëshuar në favor të Bankës Tregtare Raiffeisen Bank Albania, në kuadër të kushteve të kontratës së kredisë që do nënshkruhet ndërmjet kësaj banke dhe KESH, sh.a.-së”, ka vendosur miratimin e lëshimit të kësaj garancie qeveritare. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu e më poshtë i quajtur “Garantori”), përfaqësuar nga ministri i Financave, lëshon këtë garanci në favor të Raiffeisen Bank, sh.a., me kushtet e mëposhtme:

1. Këshilli i Ministrave merr përsipër të sigurojë të gjitha detyrimet e shoqërisë “KESH”, sh.a., që rrjedhin nga kontrata e kredisë nr. _____ Rep, nr. _____ Kol datë _____ “Për lëshimin e instrumenteve financiare dhe/ose kredi në llogarinë rrjedhëse”, deri në përmbushjen e plotë të tyre.

2. Këshilli i Ministrave merr përsipër në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar të paguajë në favor të kredidhënësit, Raiffeisen Bank, sh.a., çdo shumë deri në ekuivalentin në lekë të shumës 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) euro dhe të gjitha detyrimet e pashlyera të huamarrësit, plus interesat e akumuluar, penalitetet dhe të gjitha shpenzimet e tjera që rrjedhin nga kjo kontratë, me paraqitjen e kërkesës së tij të parë me shkrim (“Kërkesë për pagesë”), me kusht që të përmendet se kredimarrësi është në kushtet e njërit prej rasteve të mospërmbushjes, të përcaktuara në nenin 8 të kontratës së kredisë.

3. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së sipërpërmendur të kredisë, në rast se kredimarrësi nuk respekton kushtet dhe afatet e kësaj kontrate në lidhje me pagesën e interesit mujor apo pagesën e detyrimeve të pashlyera të kësaj kontrate, Raiffeisen Bank, sh.a.-ja, do të njoftojë me shkrim Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë të nesërmen e ditës së pagesës se ku do të përcaktojë shumën e detyrimit të papaguar nga kredimarrësi.

4. Kërkesa për pagesë duhet përmbajë një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe çdo shpenzim tjetër që është kryer në zbatim të kësaj kontrate dhe është në ngarkim të kredimarrësit. Kërkesa duhet të përmbajë gjithashtu edhe deklarin e shprehur të bankës se shuma që kërkohet të paguhet rrjedh nga kontrata e kredisë, detyrimet e së cilës nuk janë përmbushur nga ana e kredimarrësit.

5. Pagesa do të kryhet në llogarinë e treguar në kërkesën për pagesë nga ana e Raiffeisen Bank, sh.a.-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga dita e paraqitjes së kërkesës për pagesë.

6. Detyrimet e garantorit, të marra përsipër sipas kushteve të përcaktuara në këtë letërgaranci, nuk do të shuhet, nuk do të zvogëlohen ose nuk do të ndikohen në asnjë lloj forme nga riorganizimi, privatizimi, likuidimi ose çdo ndryshim tjetër në statusin e kredimarrësit.

7. Për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të kontratës së kredisë, që mund të bëhet me marrëveshje ndërmjet bankës dhe kredimarrësit, nuk është i nevojshëm miratimi i garantorit. Këto ndryshime nuk do të kenë asnjë efekt në të drejtat e bankës kundrejt garantorit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë garanci. Banka do të njoftojë me shkrim garantorin për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të kontratës së kredisë.

8. Kërkesa për pagesë, si dhe çdo njoftim tjetër në adresë të garantorit duhet të dërgohet në adresën: Ministria e Financave, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

9. Mbas përmbushjes së plotë dhe në mënyrë të pakthyeshme të të gjitha detyrimeve të kredimarrësit kundrejt bankës, sipas kontratës së kredisë dhe ndryshimeve nëse janë të aplikueshme, banka detyrohet t’i dërgojë garantorit origjinalin e kësaj garancie qeveritare menjëherë sapo t’i paraqitet kërkesa me shkrim nga garantori.

Kjo garanci do të hyjë në fuqi në datën _____ dhe do të jetë e vlefshme deri në shlyerjen

e plotë të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë kredie.

Kjo garanci qeveritare do të rregullohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje, që mund të lindë gjatë zbatimit të saj, do të zgjidhet nga gjykata kompetente shqiptare.

Garantori

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga ministri i Financave

Shkëlqim Cani

Nënshkrimi / vula